

ANDREAS EMBIRIKOS  
**ZOGJTË E AMAZONËS**  
POEZI

---

BOTIMET TOENA

ANDREAS EMBIRIKOS

ZOGJTË E AMAZONËS

poezi

Përzgjedhi dhe përktheu nga greqishtja  
Niko Kacalidha

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Një falënderim për Botimet “Agras” nga janë përzgjedhur poezitë.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Kujtim Dashi

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-45-9

© Botimet Agras dhe Leonidhas Embirikos

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësia”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

## SI KRIJIM I BRISHTË

*Marakit*

Dehja e dallgëve është kumti

Që i nis lundërtari së dashurës

Natën e qetë të pellushtë të heshtjes

Përmes yjeve që derdhen atje në bash

Drejt udhëtimit të pëlhurave dhe armëve

Është armatimi i një anije me frena

Si të karrocës që vrapon drejt ngazëllimit

Të çadrave të ciganëve me vajza të reja

Tepër provokuese edhe prej syve të tyre

Teksa kërcejnë në brymën mëngjesore.

## **LEDHATIME**

Kur dallgët përplasen në dritaret  
E anijes që udhëton drejt Indisë  
E heshtur qëndron në kabinën e saj  
Një vajzë duke kundruar dallgët  
Teksa i dashuri i ledhaton gjinjtë  
Përkthyesi i ardhshëm i gjuhës së algave  
Nëpër korridoret misterioze të Singaporit  
Me gjithë grackat e vendasve e legjendave  
Të zogjve të natës dhe shtypit të mëngjesit.

## **RREBESHI**

Mërmërimë e butë si pe gjilpëre  
Puth gishtërinjtë e vagëllimit  
Të një burri që endet kopshtit  
Që mbledh puthjet e kikirikët  
E një oferte të pakrahasueshme  
Të një oferte erotike  
Një ofertë dy-tri herë në ditë  
Para se të mbërrijë tkurrja e kohës.

## **KUMBIME**

Hapat tanë kumbojnë ende  
Mes pyllit me zukamën e insekteve  
Dhe pikave të rënuara prej acarit  
Që pikojnë nëpër gjethet e drurëve  
Dhe pastaj përplasen brenda shpellave  
Dridhja nga çdo goditje e druvarëve  
Teksa hollojnë me sëpata trungjet  
Me gojën e tyre mbushur me këngë  
Të mësuara që në moshën fëmijore  
Kur luanin kukafshehthi në mes të pyllit.

## **PIEDESTALI**

Mullari qëndron në mugëtirë  
Në të mblidhen mitet e viseve  
Mëllenjat e urimit të një prindi  
Rrëfejnë pasionet e ditës  
Dhe vajzat e tij ruajnë  
Me përkujdesje qypat e ëndrrave  
Që ende rriten dhe shumojnë  
Bregat e lashta të danaideve.

## KRISJE

Sërish këtu rripen skifterët  
Dhe degëve të dendura të pyllit  
Përçart flasin erërat që ndërthuren  
Me merimangat e qytetit të shkretë  
Me limimet e çelikut  
Me rrobat e vjetra  
Dhe me fërshëllimat e arterieve karotide  
Të një race njerëzish të panjohur dragonj që ndeshen.

## FOLJA VËSHTRONJ

Kjo kthjelltësi me renë që lundron në erë -  
Anije e kaltër e një fregate bardhëllore  
Rri mbështetur në bordin duke vështuar  
Dhe shikoj gjahun e mendimeve të mia  
Delfinë që kërcëjnë dhe zhyten në dallgë  
Vështroj fushat, anëdetet dhe malet  
Dhe një vashë leshverdhë që rri bri meje  
Ku brenda syve të saj paqësorë dallohet  
Ardhmëria e saj e plotë dhe e tashmja ime.

## SEKRETE

Me breshërinë e erës në flokët  
E gruas që rrotullohet në mes të sallonit  
Dhe e merr jetën e saj ashtu siç i vjen  
Me stolitë dhe fëmijët që e adhurojnë  
Dhe thërrasin gjithmonë emrin e saj  
Dhe me burrat që ngrenë  
Dorën e tyre lart në qiell  
Me rrahjen normale të pulsit  
Në gjeratoren e valsit që afron  
Gjinjtë e tyre me gjinjtë e gruas.

## VAJZA

Shtëpia gëlon prej ngazëllimit  
Si kusia plot qumësht në diell  
Një vajzë fshehtas në dritare  
U jep gjinjtë e saj pëllumbave.

Të fryra të ngjeshura gjinjtë  
Me thithkat ngritur përpjetë  
Vijnë dhe i thithin zogjtë  
Dhe befash vërshon qumështi.

## ANDREA BRETON

Zogu i pashoq i gjithësisë  
Qëndron kristalor në lartësitë e Himalajave  
Shkëlqimtar me guxim e pasion  
Përmes shkëmbit të farës tënde.

Zogu heroik i gjithësisë  
Që ngjan me kryeengjëllin dhe luanin  
Nuk pëshpërite kurrë asnjë gënjeshtër  
Po ngrite zërin tënd në kaltërsinë e kulluar.

Zogu fanatik i gjithësisë  
I fortë në luftë tërë fryte nga brendia  
Gjithnjë fluturues mes flatrave të tua  
Hap e mbyll përherë me besim syrin.

## DHJAMË

*Për Nikos Engonopulos*

Kandari anon sipas preferencës  
Sipas shpjegimit që i bëjmë  
Sa herë ngrihet plumbi.

Dhe shiko se si kemi fituar përsëri  
Se zaret ranë në barkun e një gruaje  
Të një gruaje që flinte e zbuluar  
Mbi rërën pasi kishte dalë nga deti.

Kjo grua sipas thënies së miteve  
Pati guximin të parakalonte e vetme  
Cullake me dhjamin e notarit trupit  
Një det i gjerë dhe i fryrë  
Nga psherëtimat e ëmbla të engjëjve.



## **BREGDETI**

Jemi në bregdet si skelat  
Duart tona drejtuar qiellit  
Kapin zogitë në erë  
Dhe zërat e udhëtarëve

Ndodhë të na ndalojë një grua  
Nëse nuk buzëqesh, shi mund të bjerë.

## **MUGULLIMI**

Në duart tona gëlojnë kalamajtë  
Dhe luajnë me krenat tanë  
Dhe dëgjojnë zërin tonë.

Krenat tanë rrojnë  
Lidhur me trupat  
Lëvduar qofshim ne dhe gratë  
Lëvduar qofshin kalamajtë tanë.

## SHIGJETAT

Një vajzë në një kopsht  
Dy gratë mes një saksie  
Tri vajza në zemrën time  
E habitshme, e habitshme.

Një pëllëmbë në xham  
Një pëllëmbë mbi një gji  
Një kopsë që zbërthehet  
Një gjoks që zbulohet  
Kur Shigjetari me shigjetat  
Ndriçon atje sipër në qiell  
E habitshme, e habitshme.

## SHESTIM

Zhytja e korbit mes gjithësisë  
Merr me vete ujërat e lumenjve  
Derdhen shkëmbinjtë në shishe  
Dhe vera priset.

Tufa fishekzjarrësh mes buqetave  
Batica kujtimesh të atypëratyshme  
Teatër i plotë i botës që ulërin  
Çdo kujtesë në mjegullim.